

**Letër e hapur  
Kryetarit të Komunës së Hanit të Elezit z. Rufki Suma**

I nderuari z. Suma,

Fillimisht, dëshirojmë të jua urojmë mandatin e fituar, duke shpresuar që katër vitet e ardhshme do t'i shfrytëzoni për prosperitetin e komunës suaj dhe përmbushjen e premtimeve të dhëna, në bazë të të cilave qytetarët ju kanë dhënë besimin.

Instituti për Studime të Avancuara GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) kanë monitoruar aktivitetet dhe premtimet e juaja, të dhëna gjatë fushatës zgjedhore në periudhën 15 tetor – 14 nëntor 2009 dhe 7 – 12 dhjetor 2009. Si rezultat i monitorimit tonë të bërë në mediat e shkruara dhe elektronike, si dhe në dy debatet e juaja të mbajtura në "Jeta në Kosovë", ju keni premtuar:

- Menaxhimin e drejtë dhe ngritjen e kapaciteteve në administratën komunale;
- Mbrojtjen e ambientit me anë të vendosjes së një aparati i cili do të bëjë matjen e gazrave të ndryshme që lirohen dhe vendosjes së filtrave në kompaninë e çimentoresh;
- Rregullimin e infrastrukturës rrugore;
- Përmirësimin e shërbimeve shëndetësore dhe atyre sociale;
- Përmirësimin e kushteve në arsim;
- Krijimin e kushteve më të mira për zhvillimin e biznesit;
- Përkujdesjen ndaj familjeve të dëshmorëve dhe atyre të dala nga lufta;
- Vërjen e shtëpisë së zjarrfikësve në funksion 24 orësh;
- Shndërrimin e nënstacionit policor në stacion policor, dhe rregullimin e zyrës për lëshimin e dokumenteve;
- Krijimin e kompanisë publike për mirëmbajtjen e mbeturinave;
- Krijimin e kompanisë publike për menaxhimin e ujit të pijshëm;
- Përfundimin e rrugës Hani i Elezit – Pal – Denic;
- Rregullimin e rrugës për fshatin Gorancë, rrugës së fshatit Dimc, si dhe rrugës për te varrezat e dëshmorëve;

Për fund, ju bëjmë me dije se Instituti GAP dhe BIRN, në fund të çdo viti kalendarik, do të dalin me raporte vlerësuese rreth përmbushjes së premtimeve të dhëna nga kryetarët e komunave.

Ju urojmë qeverisje të suksesshme dhe shpresojmë në bashkëpunimin tuaj edhe në të ardhmen.

Sinqerisht,

Instituti për Studime të Avancuara GAP  
Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN)